

## RAPORT I PËRKOHSHËM 7–27 shtator 2021

1 tetor 2021

### I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Më 17 tetor, votuesit do të zgjedhin kryetarët dhe këshillat e 80 komunave dhe të Qytetit të Shkupit. Në komunat ku asnjë kandidat për kryetar komune nuk e fiton shumicën e kërkuar absolute, dy javë më vonë mbahet rrethi i dytë, midis dy kandidatëve me numër më të madh votash.
- Zgjedhjet lokale kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutën e vitit 1991 dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2006. Kodi Zgjedhor është ndryshuar ndjeshëm që nga viti 2017 dhe është ndryshuar së fundmi më 15 shtator 2021, me synimin e deklaruar për t'i adresuar rekomandimet paraprake të ODIHR-it. Ndryshimet, të cilat vlejné për këto zgjedhje, u miratuan shumë afër ditës së zgjedhjeve dhe pa asnjë diskutim publik, megjithëse kishin mbështetje të gjerë politike nga të gjitha partitë parlamentare.
- Zgjedhjet administrohen nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit (KZQSh), dhe rreth 3,480 Këshilla Zgjedhorë (KZ). Organet e administratës zgjedhore deri tani i kanë respektuar shumicën e afateve ligjore. KSHZ-ja ka mbajtur mbledhje të rregullta të hapura, ndërsa korniza ligjore parasheh që vëzhguesit ndërkombëtarë dhe qytetarë, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të garuesve ta ndjekin procesin zgjedhor në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Jo të gjitha vendimet dhe udhëzimet e KSHZ-së janë publikuar në faqen e internetit të KSHZ-së në kohën e duhur. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor ndikuan dhe i vonuan përgatitjet teknike dhe administrative të zgjedhjeve dhe kërkonin përshtatje të udhëzimeve, programeve të trajnimit dhe edukimit, të KSHZ-së, si dhe të materialeve dhe procedurave të ditës së zgjedhjeve.
- Listat Zgjedhore nxirren nga regjistri i përhershëm i votuesve, i cili përditësohet periodikisht dhe, më datën 24 shtator, përfshinte rreth 1.8 milion votues. Identifikimi biometrik i votuesve futet në përdorim për herë të parë brenda një afati të ngushtë për realizim, pa një projekt pilot fillestar ose testim gjithëpërfshirës. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë partitë politike, e mirëpritën përdorimin e identifikimit biometrik të votuesve, si një mjet efektiv për të parandaluar mashtrimin. Megjithatë, disa prej tyre shprehën shqetësime se problemet e mundshme me përdorimin e pajisjeve mund të ndikojnë negativisht në besimin e publikut në integritetin e zgjedhjeve dhe në administrimin e zgjedhjeve.
- Kandidatët për kryetarë të komunave dhe listat për Këshillat komunalë regjistrohen nga KZK-të përkatëse dhe KZQSh-ja. Kandidatëve të pavarur iu kërkuar t'i dorëzojnë nënshkrimet e votuesve që e kanë mbështetur kandidaturën e tyre. Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 40 për qind për listat e Këshillave komunalë. Gjithsej 571 lista kandidatësh për këshillat komunalë, duke përfshirë rreth 45 për qind të kandidateve gra, dhe 299 kandidatë për kryetarë komune, 25 nga të cilët janë gra, u regjistruan brenda afatit ligjor.
- Periudha zyrtare e fushatës për këto zgjedhje filloi më 27 shtator dhe do të përfundojë më 16 tetor. Kodi Zgjedhor përmban dispozita që e ndalojnë përdorimin e burimeve administrative në fushatë, të cilat u plotësuan me ndryshimet e bëra në shtator. Ambienti para fushatës në përgjithësi ka qenë

paqësor. Megjithatë, shumë palë të interesuara kanë ngritur shqetësime në lidhje me retorikën negative që u shfaq në garat me konkurrencë të rreptë.

- Fushatat zgjedhore financohen me mjete publike dhe private. Të gjitha transaksionet e fushatës duhet të administrohen përmes një llogarie të dedikuar bankare dhe garuesit duhet të dorëzojnë katër raporte financiare, dy para dhe dy pas ditës së zgjedhjeve. Raportet e financimit të fushatës duhet të publikohen në internet, ndërsa revizion të raportit përfundimtar duhet të bëjë Enti Shtetëror i Revizionit, i cili ka kompetenca të kufizuara mbikëqyrëse para zgjedhjeve. KSHPK-ja ka autorizimin të fillojë procedurë sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*) gjatë gjithë periudhës zgjedhore.
- Numri i madh i mediave janë të ndara përgjatë vijave politike. Televizioni dhe mediat online janë burimet kryesore të informimit politik. Kodi Zgjedhor kërkon që të gjitha mediat, duke përfshirë edhe mediat online, t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, ndërsa transmetuesit publik i kërkohet t'u sigurojë garuesve hapësirë për transmetim falas gjatë kohës me shikueshmëri më të madhe. Reklamata e paguara politike në mediat private transmetuese, të shkruara dhe ato online gjatë periudhës së fushatës financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit. Respektimi i kërkesave ligjore nga ana e mediave mbikëqyret nga Agjencia për Shërbime dhe Audio dhe Audiovizuale Mediatike, duke përfshirë edhe monitorimin e periudhës së fushatës nga ana e saj.
- Kundërshtimet mund të parashtrihen te KZK-të, KSHZ-ja dhe gjykatat themelore. Kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative mund të parashtrihen në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Votuesit mund të parashtrijnë kundërshtime vetëm në lidhje me listat e votuesve dhe për shkeljen e të drejtës së tyre për të votuar. KSHZ-ja dhe KSHPK-ja kanë raportuar disa kundërshtime. Pas ndryshimeve të shtatorit, Gjykata Administrative ka parashtruar një kërkesë zyrtare për sqarim në lidhje me afatet për shqyrtimin e kundërshtimeve të ditës së zgjedhjeve.

## II. HYRJE

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të 17 tetorit të vitit 2021, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) më 7 shtator e krijoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ)<sup>1</sup>. Misioni i udhëhequr nga Tana de Zulueta, përbëhet nga 13 anëtarë të ekipit kryesor në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë, të cilët më 15 shtator u shpërndanë në 9 lokacione në mbarë vendin. Anëtarët e misionit janë siguruar nga 19 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. ODIHR u ka kërkuar Shteteve pjesëmarrëse që të dërgojnë 250 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar procedurat e ditës së zgjedhjeve.

## III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Më 6 gusht të vitit 2021, Kryetari i Kuvendit i shpalli zgjedhjet lokale për më 17 tetor. Zgjedhjet më të fundit lokale u mbajtën në vitin 2017, kur koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), e cila kishte krijuar me sukses një koalicion qeverisës pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në dhjetor të vitit 2016, fitoi kontrollin në shumicën e komunave.<sup>2</sup> Qeveria, e

<sup>1</sup> Shih [raportet e mëparshme ODIHR-it për zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut](#).

<sup>2</sup> Aktualisht, nga 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit, LSDM-ja ka 57 kryetarë komunash, Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) i shqiptarëve etnikë 10, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) 5, dhe Aleanca për Shqiptarët (ASH) 3, ndërsa 3 kryetarë komunash janë të pavarur. Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH), Lëvizja BESA e shqiptarëve etnikë (BESA) dhe Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM) kanë nga një kryetar komune.

kryesuar nga kryetari i LSDM -së Zoran Zaev, mbështetet nga një koalicion i LSDM-së, BDI-së dhe disa partive më të vogla politike.<sup>3</sup>

Gratë janë më pak të përfaqësuara në funksionet e zgjedhura publike, me vetëm 45 nga 120 vende në parlamentin aktual, dhe 4 nga 15 postet ministrore në qeveri. Në zgjedhjet lokale të vitit 2017, gratë u zgjodhën në 6 nga 81 postet e kryetarëve të komunave dhe përfaqësuan rreth 34 për qind të këshilltarëve të zgjedhur.

Aspiratat shumëvjeçare të vendit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe shtyrjet e ndërlidhura të bisedimeve për anëtarësim, mosmarrëveshjet mbi menaxhimin e pandemisë së COVID-19 nga qeveria, shqetësimet mbi situatën ekonomike, veçanërisht shkalla e lartë e papunësisë dhe shqetësimet mbi retorikën negative politike e formojnë sfondin e këtyre zgjedhjeve. Regjistrimi i popullsisë, i pari që nga viti 2002, filloi më 5 shtator dhe është planifikuar të zgjasë deri më 30 shtator.

#### IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet lokale kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutën e vitit 1991 dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2006. Ligjet e tjera relevante përfshijnë Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004, Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave të vitit 2019, Ligjin për Mediat të vitit 2013 dhe Ligjin për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale Mediatike të vitit 2013. Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.<sup>4</sup>

Kodi Zgjedhor është ndryshuar ndjeshëm që nga zgjedhjet e fundit lokale, duke përfshirë edhe dy herë në vitin 2021.<sup>5</sup> Më 2 prill u miratuan ndryshimet për t'i plotësuar dispozitat për identifikimin biometrik të votuesve. Më 15 shtator, Kuvendi papritur miratoi një numër ndryshimesh, shumica e të cilave vlejné për këto zgjedhje lokale. Ndryshimet përfshijnë dispozita që kanë të bëjnë me të drejtat e votimit të qytetarëve me aftësi të kufizuara intelektuale, tërheqjen e listave të kandidatëve, masat mbrojtëse kundër keqpërdorimit të burimeve publike, zhvillimin e fushatës në media, afatet për dorëzimin dhe shqyrtimin e kundërshtimeve dhe mandatin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). Megjithëse Kuvendi njoftoi se këto ndryshime rrjedhin nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, MVZ-ja e ODIHR-it u informua se një reformë zgjedhore më gjithëpërfshirëse është planifikuar për periudhën pas zgjedhjeve, për t'i implementuar, ndër të tjera, rekomandimet e ODIHR-it të cilat mbeten të patrajuara.

Ndryshimet e 15 shtatorit u miratuan me procedurë të shkurtuar, pa debat publik paraprak.<sup>6</sup> Megjithëse pranuan se ndryshimet u miratuan shumë afër ditës së zgjedhjeve, shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-

<sup>3</sup> Qeveria aktuale përfshin gjithashtu një ministër nga Lëvizja BESA (BESA) dhe një nga Partia Liberal Demokratike (PLD). Koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja që i fitoi zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 përfshinte gjithsej 20 parti më të vogla.

<sup>4</sup> Duke përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 (PNDCP), Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të vitit 1965 (KNEDR), Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të vitit 1979 (KEDNG), Konventën e KB-së kundër Korrupsionit të vitit 2003 (KKBKK), Konventën e KB-së për të Drejtat e të Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006 (KDPAK), dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të vitit 1950 (KEDNJ). Maqedonia e Veriut është anëtare e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut) dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

<sup>5</sup> Më parë, ndryshimet në Kodin Zgjedhor u miratuan në shkurt të vitit 2020, duke ndikuar në shumicën e procedurave zgjedhore dhe përgjegjësitë kryesore të administratës zgjedhore. Kodi u ndryshua gjithashtu në vitin 2017, 2018 dhe 2019.

<sup>6</sup> Një grup pune ndër-institucional, që kishte për detyrë të propozojë ndryshime të Kodit Zgjedhor dhe i formuar nga Ministria e Drejtësisë, u takua disa herë gjatë dhjetorit të vitit 2020 dhe prillit të vitit 2021. Grupi i punës u krijua fillimisht në vitin 2015 dhe u riformua pas një marrëveshjeje të 20 korrikut të vitit 2016 midis katër partive kryesore politike; grupi vazhdoi aktivitetet e tij deri në vitin 2021 nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë.

së së ODIHR-it theksuan se procesi kishte mbështetje të gjerë politike<sup>7</sup>, edhe pse palët kryesore të interesit siç është KSHZ-ja, thanë se nuk u konsultuan për propozim-ndryshimet dhe ngritën shqetësime në lidhje me miratimin e nxituar të ndryshimeve të rëndësishme dhe kapacitetin teknik për t'i zbatuar ato brenda kohës së kufizuar që kishte mbetur deri para ditës së zgjedhjeve.

Këshillat komunalë dhe kryetarët e komunave do të zgjidhen për një mandat katërvjeçar, në zgjedhje të drejtpërdrejta në 80 komunat dhe në Qytetin e Shkupit. Zgjedhjet e këshilltarëve mbahen sipas sistemit proporcional të përfaqësimit me lista të mbyllura, pa prag.<sup>8</sup> Kryetarët e komunave zgjidhen sipas sistemit të shumicës me dy rrethe zgjedhore. Nëse asnjë kandidat nuk fiton shumicën absolute të votave të hedhura në rrethin e parë të zgjedhjeve, dy javë më vonë mbahet rrethi i dytë, midis dy kandidatëve me numër më të madh votash. Së paku një e treta e votuesve të regjistruar në një komunë duhet të votojnë në rrethin e parë që zgjedhjet për kryetar të komunës të jenë të vlefshme, përndryshe zgjedhjet duhet të përsëriten. Kërkesa për pjesëmarrje të votuesve nuk zbatohet për rrethet e dyta të mundshme dhe për zgjedhjet e këshillave komunalë.

## V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet lokale administrohen nga një strukturë në tre nivele, e udhëhequr nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) dhe e përbërë nga 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit (KZQSh), si dhe rreth 3,480 Këshilla Zgjedhorë (KZ).<sup>9</sup> Përbërja e çdo organi për menaxhim të zgjedhjeve duhet t'i plotësojë kërkesat ligjore për përfaqësimin gjinor dhe etnik.<sup>10</sup>

KSHZ-ja është një organ i përhershëm i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi. Pas një procesi të hapur të rekrutimit, katër anëtarë, duke përfshirë edhe nënkryetarin, propozohen nga partitë në pushtet, ndërsa tre anëtarë, duke përfshirë edhe kryetarin, nga partitë opozitare, nga një listë paraprake e aplikuesve. KSHZ-ja në përbërjen e saj aktuale u emërua në janar të vitit 2021 për një mandat të përkohshëm dyvjeçar; megjithatë, me ndryshimet e bëra më 15 shtator u fut një mandat pesëvjeçar.<sup>11</sup> Vetëm dy nga anëtarët aktualë të KSHZ-së janë gra, duke përfshirë edhe nënkryetaren. Për çështjet administrative dhe organizative, KSHZ-ja ndihmohet nga shërbimi profesional, i udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm. Mandati i sekretarit të përgjithshëm të mëparshëm skadoi në janar të vitit 2021 dhe që atëherë pozita është e paplotësuar.

KZK-të dhe KZQSh-ja aktuale, si dhe anëtarët jopartiakë të KZ-ve, u emëruan në qershor dhe korrik të vitit 2021, me mandate pesëvjeçare dhe katërvjeçare, respektivisht.<sup>12</sup> KZK-të e mbikëqyrin

<sup>7</sup> Ndryshimet u parashtruan nga deputetë të gjashtë grupeve kryesore parlamentare, që përfaqësonin edhe pushtetin edhe opozitën, dhe u miratuan pothuajse unanimisht (78 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim).

<sup>8</sup> Numri i këshilltarëve përcaktohet nga madhësia e popullsisë së komunës dhe ndryshon nga 9 deri në 33, ndërsa 45 përfaqësues zgjidhen në Këshillin e Qytetit të Shkupit. Mandatet shpërndahen duke përdorur formulën e d'Hondt-it. Reforma e paralajmëruar zgjedhore parashikon ndryshimin e sistemit zgjedhor për të futur lista të hapura të kandidatëve.

<sup>9</sup> Numri përfundimtar i KZ-ve që do të jenë funksionale do të përcaktohet vetëm pas përfundimit të procesit të regjistrimit të votuesve, duke qenë se vendvotimet nuk do të hapen në zonat në të cilat ka më pak votues se numri minimal prej dhjetë votuesve të regjistruar që kërkohet për krijimin e një vendvotimi.

<sup>10</sup> Çdo gjini duhet të përfaqësohet nga të paktën 30 për qind e anëtarëve, e po ashtu duhet të përfaqësohen edhe të gjitha bashkësitë etnike që përbëjnë të paktën 20 për qind të popullsisë në komunën përkatëse.

<sup>11</sup> Ndryshimet e shtatorit të vitit 2021 përcaktojnë se në rast të ndryshimit të qeverisë, përbërja e KSHZ-së do të harmonizohet në mënyrë përkatëse.

<sup>12</sup> KZK-të dhe KZQSh-ja përbëhen nga pesë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KSHZ-ja nga radhët e punonjësve të administratës shtetërore dhe komunale. KZ-të përbëhen nga tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve publikë dhe shtetërorë me mandat katërvjeçar dhe dy anëtarë të përkohshëm dhe zëvendësit e tyre, të emëruar nga partitë parlamentare për çdo zgjedhje. Secila nga dy partitë në pushtet dhe dy partitë opozitare, që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare, emërojnë nga një anëtar dhe një zëvendës.

administrimin e zgjedhjeve në komunën përkatëse, i regjistrojnë kandidatët, i emërojnë dhe i trajnojnë KZ-të, dhe menaxhojnë me përgatitjet e tjera teknike. Pas përzgjedhjes fillestare, gratë përbënin 49 për qind të anëtarëve të KZK-ve dhe KZQSh-së, duke kryesuar me 39 nga 81 organe të nivelit të mesëm. Në disa komuna, përbërja e KZK-ve dhe KZ-ve ende nuk është finalizuar, pasi është raportuar një largim i konsiderueshëm midis anëtarëve të përzgjedhur, kryesisht për shkak të arsyeve shëndetësore ose konfliktit të interesit në rastet e anëtarëve që janë kandiduar në zgjedhje.

Deri më tani, organet e administratës zgjedhore i kanë respektuar shumicën e afateve ligjore. KSHZ-ja ka mbajtur mbledhje të rregullta të cilat kanë qenë të hapura për mediat, vëzhguesit dhe përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve dhe të cilat janë transmetuar drejtpërdrejt në internet, me ç'rast incizimet ishin në dispozicion edhe në kanalën e KSHZ-së në YouTube. Mbledhjet lajmërohen vetëm përmes listës zyrtare të e-mail-ëve, shpesh pak para se të mbahen mbledhjet. Jo të gjitha procesverbalet e mbledhjeve, vendimet dhe udhëzimet e miratuara janë publikuar në faqen e internetit të KSHZ-së në mënyrë konsekuente dhe në kohë.

Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor ndikuan dhe i vonuan përgatitjet teknike dhe administrative të zgjedhjeve dhe kërkonin përshtatje në momentin e fundit të udhëzimeve, programeve të trajnimit dhe edukimit, të KSHZ-së, si dhe të materialeve dhe procedurave të ditës së zgjedhjeve. Sektori i trajnimit i KSHZ-së zhvilloi një program trajnimi gjithëpërfshirës dhe i përfundoi trajnimet fillestare të KZK-ve dhe trajnerëve të certifikuar nga KSHZ-ja deri në mes të shtatorit; megjithatë, këto trajnime nuk e mbuluan përdorimin e pajisjeve biometrike për identifikimin e votuesve (PBIV) dhe i përfshinë procedurat zgjedhore në fuqi para miratimit të ndryshimeve të fundit. Sesionet shtesë të trajnimit për trajnerët e KSHZ-së për përdorimin e PBIV dhe procedurat e reja u mbajtën më 24 dhe 25 shtator, pas miratimit të udhëzimeve të rishikuara dhe konfigurimit të pajisjeve teknike.

## VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është marrë e drejta e votës plotësisht ose pjesërisht me vendim të gjykatës në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale.<sup>13</sup> Për t'u përfshirë në regjistrin e votuesve, qytetarët duhet të kenë adresë të regjistruar në vend dhe letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme. Ndryshimet e shtatorit të vitit 2021 u lejojnë qytetarëve, letërnjoftimi i të cilëve ka skaduar pas shpalljes së zgjedhjeve dhe të cilët kanë kërkuar letërnjoftim të ri deri në ditën e zgjedhjeve, që të përfshihen në regjistrin e votuesve. Për shkak të kontradiktave në Kodin Zgjedhor në lidhje me azhurnimin e regjistrit të votuesve, qytetarët që mbushin 18 vjet midis rrethit të parë dhe të dytë nuk janë të përfshirë.

KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të votuesve, nga i cili nxirren Listat Zgjedhore, në bazë të përditësimeve të rregullta nga institucionet e ndryshme shtetërore.<sup>14</sup> Në praktikë, Enti Shtetëror Statistikor siguron përpunimin teknik dhe metodologjik të të dhënave nga regjistri i votuesve. Kërkesa ligjore që regjistri i zgjedhësve të nxirret nga Regjistri Kombëtar i Popullsisë ende nuk është zbatuar. Të gjithë bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në saktësinë dhe besueshmërinë e regjistrit të votuesve, megjithëse disa pranuan se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve që banojnë jashtë vendit mbeten në regjister pasi mbajnë një vendbanim zyrtar në vend.

<sup>13</sup> Ndryshimet e shtatorit të vitit 2021 prezantuan mundësinë që qytetarët të cilët janë pjesërisht të privuar nga aftësia ligjore ta rifitojnë të drejtën e tyre të votimit në bazë të vendimit të gjykatës, por kjo dispozitë në praktikë nuk ka efekt në të drejtat e votës për këto zgjedhje.

<sup>14</sup> Duke përfshirë edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe gjykatat themelore.

Më 24 shtator, KSHZ-ja e mbylli regjistrin e votuesve, me gjithsej 1,824,864 votues dhe filloi shtypjen e Listave Zgjedhore.<sup>15</sup> Qytetarët mund t'i kontrollojnë të dhënat e tyre në regjistrin e votuesve në internet dhe në zyrat rajonale të KSHZ-së gjatë gjithë vitit, si dhe gjatë periudhës së këqyrjes publike, e cila u zhvillua nga 21 gushti deri më 9 shtator.<sup>16</sup> Midis 15 dhe 20 shtatorit, të gjitha partitë që garojnë në zgjedhje kishin mundësi të marrin një kopje elektronike të regjistrit të zgjedhësve, pa mbrojtje nga kopjimi.<sup>17</sup> Afati kohor që partitë të parashtrajnë ankesa ndaj vendimeve të KSHZ-së në lidhje me regjistrin e votuesve mund ta pengojë KSHZ-në që ta mbyllë regjistrin deri në fund të afatit ligjor; në këto zgjedhje nuk kishte ankesa të tilla. Ligji nuk parashikon këqyrje të regjistrit nga kandidatët e pavarur.

Identifikimi biometrik i votuesve, i cili u fut në Kodin Zgjedhor me ndryshimet e bëra në shkurt të vitit 2020, do të përdoret për herë të parë në këto zgjedhje për të gjithë votuesit në vendvotimet e rregullta, pa realizuar një projekt pilot dhe pa kohë të mjaftueshme për testimin gjithëpërfshirës të harduerit dhe softuerit. Procesi i furnizimit publik nuk u fillua deri në qershor të vitit 2021, pas të cilit, në gusht të vitit 2021, u furnizuan gjithsej 4,000 PIBV të lëvizshme.<sup>18</sup> Shumica e makinave nuk u dorëzuan deri një muaj para ditës së caktuar të zgjedhjeve.<sup>19</sup>

Lista Zgjedhore të secilit vendvotim duhet të ngarkohet në pajisje, e cila do t'i skenojë gjurmët e gishtërinjve të votuesve për ta verifikuar identitetin e tyre duke i përputhur gjurmët e gishtërinjve me ato të regjistruara në pajisje.<sup>20</sup> Me PIBV-të, të cilat nuk janë të lidhura në rrjet ose të lidhura në internet, do të merret kryetari ose nënkryetari i KZ-së. Listat e shtypura në letër do të përdoren si zëvendësim, në rast të problemeve teknike me PIBV-të. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë partitë politike, e mirëpritën futjen në përdorim të identifikimit biometrik të votuesve, si një mjet efektiv për të parandaluar mashtrimin, duke përfshirë votimin e shumëfishtë dhe prezantimin e rrejshëm në emër të ndonjë votuesi tjetër. Megjithatë, disa prej tyre shprehën shqetësime se problemet e mundshme me përdorimin e pajisjeve të reja mund të ndikojnë negativisht në besimin e publikut në integritetin e zgjedhjeve dhe në administrimin e zgjedhjeve.

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Qytetarët që janë të paktën 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve dhe kanë të drejtë vote, kanë të drejtë të kandidojnë për postin e kryetarit të komunës ose për këshilltar në komunën e vendbanimit të tyre të regjistruar. Korniza ligjore i ndalon të kandidojnë në zgjedhje ata që aktualisht vuajnë ose presin të vuajnë dënim të plotfuqishëm prej më shumë se gjashtë muaj burgim.

Kandidatët për kryetar komune dhe këshilltarë mund të emërohen nga partitë e regjistruara politike ose nga koalicionet partish, ose mund të kandidojnë në mënyrë të pavarur (individualisht për kryetar

<sup>15</sup> Duke përfshirë edhe 82,461 votues të regjistruar si banorë jashtë vendit, të cilët kanë të drejtë të votojnë në vend, por janë përfshirë në lista të veçanta, si dhe 2,250 në institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe në institucionet e kujdesit, të cilët kanë të drejtë të votojnë një ditë më herë, më 16 tetor.

<sup>16</sup> Kërkimi mund të bëhet në bazë të numrin unik amë të qytetarit ose sipas adresës.

<sup>17</sup> Gjithsej 15 parti morën kopje elektronike të regjistrit të votuesve. Nga gjithsej 16 kërkesa për korrigjim të parashtruar nga 2 parti politike, 11 kërkesa për përfshirjen e votuesve u refuzuan nga KSHZ-ja.

<sup>18</sup> Tenderi i parë që u shpall më 21 maj të vitit 2021 u anulua nga Byroja për Furnizime Publike. Kontrata me kompaninë gjermane Dermalog u nënshkrua më 11 gusht të vitit 2021. Dy kompani lokale, Simboliko dhe Alphazet-Macedonia, janë nënkontraktuar për trajnimet dhe për ngarkimin e Listave Zgjedhore në pajisje, si dhe për menaxhimin e një qendre thirrjesh për asistencë teknike, respektivisht.

<sup>19</sup> Deri më 27 shtator, 1,180 nga 4,000 njësi të lëvizshme të PIBV i ishin dorëzuar KSHZ-së. Dërgesat e mbetura priten të arrijnë në vend deri më 2 tetor.

<sup>20</sup> Nëse gjurma e gishtit të një votuesi nuk mund të gjendet në listën elektronike të gjurmëve të gishtërinjve të votuesve, identifikimi i votuesit do të bëhet duke e skenuar letërnjoftimin e votuesit ose duke e futur numrin unik amë të qytetarit.

komune, ose, në rastin e këshilltarëve, në lista), të mbështetur nga grupe votuesish.<sup>21</sup> Çdo gjini duhet të përbëjë të paktën 40 për qind të kandidatëve në të gjitha listat për këshillat komunalë, me kërkesë që kandidati i gjinisë më pak të përfaqësuar të përfshihet në secilin grup prej tre vendeve të njëpasnjëshme, me një vend shtesë brenda çdo grupi prej dhjetë kandidatësh të rezervuar për kandidatin e gjinisë më pak të përfaqësuar.

Për të mbështetur kandidaturat e pavarura, grupet e votuesve duhet të mbledhin midis 100 dhe 450 nënshkrime mbështetëse të votuesve që banojnë në komunën përkatëse, në varësi të madhësisë së popullsisë së komunës, dhe të paktën 1,000 nënshkrime për listat e kandidatëve në nivelin e Qytetit të Shkupit. Për këto zgjedhje, nënshkrimet mbështetëse u mbledhën midis 16 dhe 30 gushtit, në prani të zyrtarëve të KSHZ-së, në zyrat rajonale të KSHZ-së ose në zyrat e noterëve të caktuar.<sup>22</sup>

Dokumentet për emërim duhej të dorëzoheshin te KKZ-të dhe KZQSh-ja deri më 11 shtator. Pas pranimit të tyre, KKZ-të dhe KZQSh-ja kishin 24 orë kohë për t'i verifikuar dokumentet e dorëzuara. Parashtruesit e listave të kandidatëve kishin dy ditë për t'i korrigjuar mangësitë eventuale të identifikuar në dokumentet për emërim. Disa KZK e informuan MVZ-në e ODIHR-it se ata nuk ishin gjithmonë në gjendje t'i respektonin të gjitha afatet, për shkak të dorëzimit të vonshëm të të dhënave në lidhje me dosjet penale të kandidatëve nga gjykatat.<sup>23</sup>

Sipas KSHZ-së, brenda afatit ligjor deri më 18 shtator, KZK-të dhe KZQSh-ja regjistruan gjithsej 10,649 kandidatë në 571 lista të kandidatëve për këshillat komunalë të parashtruara nga 28 parti politike, 6 koalicione dhe 58 grupe votuesish. Gratë përbëjnë rreth 45 për qind të të gjithë kandidatëve për këshilltarë dhe janë bartëse në 111 lista të kandidatëve (19 për qind). Në zgjedhjet për kryetarë komune do të garojnë gjithsej 299 kandidatë (duke përfshirë 25 gra, ose 8 për qind) të propozuar nga 22 parti politike, 5 koalicione dhe 25 grupe votuesish. MVZ-ja e ODIHR-it është në dijeni të refuzimeve të tre kandidatëve për kryetarë të komunave dhe nëntë listave të kandidatëve për këshilltarë komunalë nga KZK-të për shkak të dorëzimit të vonuar ose mangësive në dokumentet për emërim.

## VIII. AMBIENTI I FUSHATËS

Periudha zyrtare e fushatës filloi më 27 shtator dhe përfundon më 15 tetor në mesnatë.<sup>24</sup> Kodi Zgjedhor përmban dispozita që e ndalojnë përdorimin e burimeve administrative në fushatë, duke përfshirë moratorium, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, për publikimin e projekteve të reja të financuara me mjete publike dhe ndalesë për përdorimin e zyrave, pajisjeve apo punonjësve shtetërorë për fushatë, dhe presionin ndaj nëpunësve publikë. Pas shpalljes së zgjedhjeve, nuk mund të bëhen pagesa të rrogave, pensioneve dhe ndihmave sociale, përveç pagesave të rregullta, nga mjetet buxhetore. Ndryshimet e

<sup>21</sup> Kodi Zgjedhor kërkon që numri i kandidatëve në listat e parashtruara të jetë i barabartë me vendet që janë në dispozicion në komunën përkatëse, gjë që i pamundëson kandidatët të konkurrojnë individualisht. Të gjitha listat e parashtruara të kandidatëve duhet të shoqërohen me certifikatat e regjistrimit të partive politike, sipas rastit; një deklaratë të parevokueshme të pëlqimit me kandidaturën, deklaratë për përkatësinë në bashkësinë etnike dhe kopje të letërnjoftimit ose pasaportës së vlefshme të secilit kandidat; konfirmimi i numrit unik tatimor nga Regjistri Qendror; konfirmimi për hapjen e llogarisë bankare të dedikuar vetëm për qëllime të fushatës; dhe një simbol zgjedhor, nëse ka, në formë digjitale.

<sup>22</sup> Nga 69 grupe votuesish që synonin të propozonin lista të kandidatëve për këshillat komunalë, 67 e mbledhën numrin e kërkuar të nënshkrimeve. Për emërimin e kandidatëve për kryetarë të komunave, 30 nga 38 kandidatët të pavarur të mundshëm mbledhën numrin e nënshkrimeve të nevojshme për regjistrim.

<sup>23</sup> Për shembull, në komunat e Aerodromit, Butelit, Qendrës, Petrovecit, Sopishtes dhe Vinicës.

<sup>24</sup> Disa garues filluan t'i përfshijnë votuesit në aktivitete para fillimit zyrtar të fushatës. Për shembull, bilbordet që i përmendin arritjet e LSDM-së dhe që i kritikojnë veprimet e VMRO-DPMNE-së mund të shihen në Shkup dhe në disa komuna të tjera. Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it u informuan se kandidati i LSDM-së për kryetar komune është takuar me votuesit në Prilep dhe i ka angazhuar ata në faqen e tij në Facebook, si dhe për kandidatët e LSDM-së dhe të VMRO-DPMNE-së që janë takuar me votuesit në Krushevë. Në Shkup, koalicioni Qyteti i Gjellbër Human mbajti një ngjarje publike me votuesit më 22 shtator.

shtatorit të vitit 2021 i plotësuan rregullat ekzistuese që e rregullojnë fushatën dhe synojnë ta rrisin transparencën e përdorimit të burimeve publike, siç janë automjetet, gjatë fushatës zgjedhore.

Në zgjedhjet e ardhshme lokale do të garojnë partitë politike dhe koalicionet e udhëhequra nga partitë, si dhe një numër i madh i kandidatëve të pavarur të mbështetur nga grupe të votuesve.<sup>25</sup> Gjatë periudhës raportuese, ambienti para fushatës në përgjithësi ka qenë paqësor. Shumica e partive njoftuan se në strategjitë e tyre të fushatës do të përdorin fushatë pozitive, si një metodë për të kundërshtuar shkëmbimin e akuzave dhe sulmet personale midis udhëheqësve politikë që i karakterizuan fushatat e mëparshme. Megjithatë, shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime mbi retorikën negative që u shfaq para fillimit zyrtar të fushatës. Partitë politike gjithashtu u zotuan se do t'i përmbahen rregullave që e rregullojnë fushatën zgjedhore duke e nënshkruar Kodin për Zgjedhje të Drejta dhe Demokratike më 23 shtator, nën patronazhin e KSHZ-së. Të gjithë garuesit që u takuan me MVZ-në e ODIHR-it theksuan se planet e tyre të fushatës do të përshtaten për t'i adresuar sfidat që u paraqitën nga pandemia e KOVID-19, duke i dhënë përparësi takimeve të vogla në komunitet ndaj tubimeve të mëdha dhe duke zhvilluar aktivitete të gjera online.

Partitë politike që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike, duke përfshirë romët, serbët dhe turqit, vazhdojnë të bashkohen me forcat më të fuqishme politike në koalicionet parazgjedhore. Për këto zgjedhje, Bashkimi Demokratik Boshnjak (BDB) për herë të parë do të garojë në mënyrë të pavarur, duke përfshirë edhe për postin e kryetarit të Qytetit të Shkupit. Palët që i përfaqësojnë komunitetet serbe dhe turke e informuan MVZ-në e ODIHR-it se pavarësisht pjesëmarrjes së tyre në koalicione më të mëdha, ato gjithashtu do të zhvillojnë aktivitete të veçanta të fushatës në komunitetet e tyre përkatëse.

## IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Fushatat zgjedhore mund të financohen nga fondet vetanake të partive politike dhe kreditë bankare, si dhe nga donacionet. Donacionet nga burime të huaja, shtetërore, komunale dhe anonime, si dhe nga organizatat publike, fetare dhe ato bamirëse janë të ndaluara. Reklamata e paguara politike në mediat transmetuese, të shkruara dhe ato online financohen drejtpërdrejt nga shteti, përmes një fondi të veçantë (Shih *Mediat*). Partitë politike që kanë marrë më shumë se një për qind të votave në zgjedhjet e mëparshme parlamentare ose lokale kanë të drejtë për financim publik për aktivitete të tyre të rregullta.<sup>26</sup>

Donacionet, qoftë monetare apo në natyrë, janë të kufizuara në 3,000 euro për individët dhe 30,000 euro për personat juridikë (në kundërvlerë në denarë, në të dy rastet). Çdo mall ose shërbim falas ose me zbritje duhet të raportohet me çmimin e tyre të tregut. Kufiri i shpenzimeve të fushatës është 110 denarë (afërsisht 1.8 euro) për votues të regjistruar në një komunë, për secilin rreth të zgjedhjeve.<sup>27</sup> Për qëllime të financimit të fushatës, ligji nuk bën dallim midis zgjedhjeve për kryetar komune dhe për këshillat komunalë.

<sup>25</sup> Konfigurimi i koalicioneve ndryshon në varësi të komunës. Për shembull, në Shkup dhe në disa komuna të tjera, koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja, "Më e mira për komunën time", përfshin partitë BDI, BESA dhe PDSH, si dhe një numër partish më të vogla; koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, "Rindërtimi i Maqedonisë", përfshin partitë ASH dhe AlternativA; ndërsa Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë (DOM) dhe Partia Liberal Demokratike (PLD) e formojnë koalicionin "Lëvizja e Përkushtuar për Ndryshim".

<sup>26</sup> Sipas Ligjit për Financimin e Partive Politike, 0.15 për qind e pjesës së të ardhurave të buxhetit vjetor të shtetit duhet të ndahet për subvencione për partitë politike. Nga kjo, 70 për qind duhet t'i ndahen partive parlamentare në proporcion me numrin e deputetëve të fituar, kurse 30 për qind duhet t'u ndahen në mënyrë të barabartë të gjitha partive që kanë marrë të paktën një për qind të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare ose lokale. Në vitin 2021, rreth 58 parti politike morën financim shtetëror; nga këto, LSDM-ja mori 49,956,552 denarë, kurse VMRO-DPMNE 44,039,448 denarë (afërsisht 818,000 dhe 722,000 euro, respektivisht). 1 euro është përafërsisht 61 denarë.

<sup>27</sup> Në varësi të madhësisë së popullsisë së komunave, kufijtë e shpenzimeve ndryshojnë nga 3,571 euro deri në 169,174 euro.



Të gjitha transaksionet e fushatës duhet të administrohen përmes një llogarie të dedikuar bankare. Garuesit duhet të mbajnë një regjistër të donacioneve dhe duhet të dorëzojnë katër raporte financiare mbi të hyrat dhe shpenzimet, dy prej të cilave duhet të dorëzohen para ditës së zgjedhjeve.<sup>28</sup> Raporti i parë paszgjedhor duhet të dorëzohet në afat prej 19 ditëve nga dita e zgjedhjeve, ndërsa raporti përfundimtar duhet të dorëzohet në afat prej 75 ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare. Raportet e financimit të fushatës duhet t'i dorëzohen KSHZ-së, Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), dhe duhet të publikohen në faqet e internetit të këtyre institucioneve.<sup>29</sup> Vetëm raporti përfundimtar i nënshtrohet revizionit nga ESHR-ja, e cila mund të fillojë inspektime dhe hetime vetëm në bazë të këtyre raporteve përfundimtare. KSHPK-ja, e cila mund të fillojë procedurë sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*) gjatë gjithë periudhës zgjedhore, e informoi MVZ-në e ODIHR-it për planet që gjatë fushatës të dërgojë 16 monitorues në terren. Kodi Zgjedhor parashikon gjopa deri në 9,000 euro për shkelje të rregullave të financimit të fushatës, duke përfshirë tejkalimin e kufirit për donacione ose shpenzime ose mosdorëzimin e raportit financiar. Sanksionet penale për shkeljen e rregullave të financimit të fushatës përfshijnë gjopa dhe dënime me burg.

## X. MEDIAT

Një numër i madh i mediave, të ndara përgjatë vijave partiake, funksionojnë në një treg të vogël për reklamim. Televizioni dhe mediat online janë burimet kryesore të informimit politik. Transmetuesi publik, Radio dhe Televizioni i Maqedonisë (RTM) financohet nga buxheti i shtetit, gjë që sipas mendimit të disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it ndikon në pavarësinë e tij redaktuese. Megjithatë bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it vunë re përmirësime të përgjithshme në fushën e mediave në vitet e fundit, ata ngritën shqetësime në lidhje me auto-censurën, nivelin e ulët të profesionalizmit, ngacmimin online, veçanërisht kundër gazetarëve femra dhe kushteve të këqija të punës në fushën e mediave.

Kodi Zgjedhor kërkon që të gjitha mediat, duke përfshirë edhe mediat online, t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, *RTM-ja* është e obliguar t'i kushtojë 30 për qind të lajmeve ngjarjeve të përgjithshme, 30 për qind partive në pushtet, 30 për qind opozitës parlamentare dhe 10 për qind partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur. Nga *RTM-ja* gjithashtu kërkohet që t'u sigurojë garuesve politikë hapësirë transmetimi falas gjatë kohës me shikueshmëri më të madhe.<sup>30</sup> Transmetuesit privatë duhet të sigurojnë kohë të barabartë transmetimi për të gjithë kandidatët për kryetarë komune, ndërsa parashtruesit e listave të këshilltarëve duhet gjithashtu të marrin kohë të barabartë transmetimi në mediat transmetuese lokale.<sup>31</sup> Transmetuesit publikë dhe privatë kombëtarë janë të detyruar ta plotësojnë gjithë mbulimin e zgjedhjeve me gjuhën e shenjave.

Reklamat e paguara politike në mediat transmetuese private, mediat e shkruara dhe ato online gjatë periudhës së fushatës financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit, gjë që është kritikuar nga disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it si gjë që potencialisht e inkurajon klientelizmin në media.<sup>32</sup> Mediat që planifikojnë të ofrojnë kohë të paguar transmetimi për garuesit duhet të regjistrohen në

<sup>28</sup> Raporti i parë i përkohshëm duhet të dorëzohet më 8 tetor, ndërsa i dyti më 16 tetor.

<sup>29</sup> Në ligj nuk është përcaktuar asnjë afat për publikimin e raporteve.

<sup>30</sup> RTM-ja siguroi studion e vet për incizimin e klipeve falas, të cilat do të transmetohen prej 4 deri më 14 tetor.

<sup>31</sup> Ligji parashikon se transmetuesit kombëtarë dhe lokalë duhet ta ndjekin parimin e proporcionalitetit, në bazë të numrit të listave të konfirmuara të kandidatëve.

<sup>32</sup> Buxheti i përgjithshëm i ndarë për fushatat mediatike nuk mund të tejkalojë 2 euro për votues të regjistruar në vend, dhe një 1 euro shtesë për votues të regjistruar gjatë rrethit të dytë. Çmimi mesatar për reklamat e paguara politike në secilën medie nuk mund ta tejkalojë shpenzimin e përgjithshëm mesatar të reklamimit të llogaritur për pesë ciklet e fundit zgjedhore. Listat e çmimeve duhet t'i dorëzohen KSHZ-së dhe të konfirmohen prej saj.

KSHZ.<sup>33</sup> Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të bëra në shtator të vitit 2021 parashikojnë, ndër të tjera, se tetë minuta kohë transmetimi me pagesë dhe 90 për qind e mjeteve financiare duhet të ndahen në mënyrë të barabartë midis dy partive më të mëdha në pushtet dhe dy partive më të mëdha opozitare parlamentare, një minutë dhe 7 për qind të mjeteve financiare duhet t'u ndahen partive më të vogla parlamentare, kurse 30 sekonda dhe 3 për qind të mjeteve financiare, partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur.

Respektimi i kërkesave ligjore nga ana e mediave në lidhje me mbulimin e zgjedhjeve mbikëqyret nga Agjencia për Shërbime dhe Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM), e cila financohet nga shteti. ASHAAM-ja filloi monitorimin e saj më 7 gusht dhe i dorëzon KSHZ-së raporte javore para periudhës zyrtare të fushatës, si dhe raporte ditore gjatë saj.<sup>34</sup> Në rast se ASHAAM-i identifikon shkelje nga ana e mediave transmetuese, ajo do të fillojë procedurë kundërvajtëse para gjykatës kompetente brenda 48 orëve.<sup>35</sup>

Më 22 shtator, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin sasior dhe cilësor të mbulimit në lidhje me zgjedhjet të gjashtë kanaleve televizive mbarëkombëtare dhe të katër ueb-faqeve me lajme.<sup>36</sup>

## XI. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

Sipas Kodit Zgjedhor, kundërshtimet mund të parashtrihen te KZK-të, KSHZ-ja dhe gjykatat themelore. Kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative mund të parashtrihen në KSHPK. Kompetenca e KZK-ve është e kufizuar në kundërshtimet e votuesve në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre gjatë procedurës së votimit. Gjykatat themelore dhe KSHZ-ja i shqyrtojnë kundërshtimet kundër shkeljeve të fushatës dhe kompetencat e tyre mbi këto çështje nuk janë përcaktuar qartë.

Gjykata Administrative është shkalla e fundit e ankimit për shumicën e kundërshtimeve. Megjithëse për vendimet e KSHZ-së për shkeljet e të drejtave individuale mund të parashtrihet ankesë në Gjykatën Administrative, rregulloret e KSHZ-së mund të kontestohen vetëm para Gjykatës Kushtetuese, dhe për këtë nuk është parashikuar procedurë e shkurtuar. Gjykatat e Apelit janë instancat e fundit për shqyrtimin e kontestimeve kundër vendimeve të gjykatave themelore në lidhje me zgjedhjet.<sup>37</sup>

Si rregull i përgjithshëm, e drejta për të parashtruar kundërshtime është e garantuar për garuesit dhe votuesit. Votuesit mund të parashtrorjnë kundërshtime vetëm në lidhje me Listat Zgjedhore dhe për shkeljen e të drejtës së tyre për të votuar. Vëzhguesit qytetarë mund të kenë vërejtje mbi parregullsitë e pretenduara të regjistruara në ditarët e KZ-ve; këto vërejtje nuk trajtohen si kundërshtime, por mund të shërbejnë si bazë për parashtrimin e kundërshtimeve nga garuesit. Afatet për parashtrimin e kundërshtimeve dhe vendosjen në lidhje me to janë të shkurtra: si rregull, ankuesit kanë deri në dy ditë për të parashtruar një kundërshtim, me ç'rast janë paraparë një deri në tre ditë për shqyrtimin e shumicës së kundërshtimeve. Pas ndryshimeve të fundit në Kodin Zgjedhor, kundërshtimet për ditën e zgjedhjeve nga votuesit duhet të parashtrihen brenda 12 orëve (më parë 24 orë) dhe duhet të shqyrtohen brenda dy

<sup>33</sup> KSHZ-ja regjistroi 35 stacione televizive, 44 stacione radio stacione, 10 media të shkruara dhe 191 faqe lajmesh në internet.

<sup>34</sup> Para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, ASHAAM-i monitoroi shtatë kanale televizive kombëtare, ndërsa synon të përfshijë disa transmetues rajonalë dhe lokalë gjatë fushatës zyrtare.

<sup>35</sup> Deri më 24 shtator, nuk është raportuar asnjë shkelje nga ASHAAM-i.

<sup>36</sup> Ato përfshijnë transmetuesit publikë *RTM1* dhe *RTM2*, transmetuesit privatë *Alsat-M*, *Kanal 5*, *Telma* dhe *Sitel*, si dhe mbulimin e zgjedhjeve nga ueb-faqet [kurir.mk](http://kurir.mk), [plusinfo.mk](http://plusinfo.mk), [tetovasot.com](http://tetovasot.com), dhe [lajmpress.org](http://lajmpress.org).

<sup>37</sup> Ekzistojnë katër Gjykata të Apelit në Maqedoninë e Veriut, me seli në Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip.

orësh. MVZ-ja e ODIHR-it u informua nga Gjykata Administrative se ndryshimet e fundit ndikuan negativisht në qartësinë e afateve kohore.<sup>38</sup>

Deri më 24 shtator, KSHZ-ja dhe KSHPK-ja raportuan shumë pak kundërshtime. Gjykata Administrative pranoi dhe shqyrtoi 12 kundërshtime në lidhje me regjistrimin e kandidatëve; të gjitha u hodhën poshtë. Pavarësisht nga kërkesa ligjore për një seancë publike, seancat në Gjykatën Administrative u mbajtën pa pjesëmarrjen e palëve në çështje, apo të publikut.

## **XII. VËZHGESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË**

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin qytetar dhe ndërkombëtar të të gjithë procesit zgjedhor. Shoqatat e qytetarëve dhe organizatat e huaja të regjistruara të paktën një vit para ditës së zgjedhjeve dhe statutet e të cilave e përfshijnë parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut mund të aplikojnë për akreditim në KSHZ për të shpërndarë vëzhgues deri në 10 ditë para ditës së zgjedhjeve.<sup>39</sup> Duke pritur të shpërndajë grupin më të madh të vëzhguesve qytetarë për këto zgjedhje, CIVIL – Qendra për Liri, ka kryer aktivitete afatgjata të vëzhgimit në të gjithë vendin që nga mesi i gushtit, duke përfshirë monitorimin e mediave, platformave të mediave sociale dhe aktiviteteve të partive politike. Subjektet me kandidatë të regjistruar kanë të drejtë të caktojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar për ta ndjekur procesin zgjedhor në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Përfaqësuesit e kandidatëve në organet zgjedhore të nivelit më të ulët mund të regjistrohen në KZK deri në dy ditë para ditës së zgjedhjeve.

## **XIII. AKTIVITETET E MVZ-SË SË ODIHR-IT**

MVZ-ja e ODIHR-it i filloi aktivitetet e saj në Shkup më 7 shtator. Shefja e Misionit është takuar me Kryetarin e KSHZ-së, Kryeministrin, Ministrin e Drejtësisë, Kryetarin e Gjykatës Administrative, Kryetarin e Komisionit Ligjdhënës-Juridik të Kuvendit dhe përfaqësuesit e partive politike. MVZ-ja e ODIHR-it ka vendosur kontakte të rregullta me KSHZ-në, institucionet qeveritare të përfshira në procesin zgjedhor, gjyqësinë, partitë politike, kandidatët, shoqërinë civile, mediat dhe komunitetin rezident diplomatik dhe ndërkombëtar.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*

<sup>38</sup> Pas ndryshimeve, Gjykata Administrative ka parashtruar një kërkesë zyrtare në Ministrinë e Drejtësisë për sqarim në lidhje me afatet për shqyrtimin e kundërshtimeve të ditës së zgjedhjeve.

<sup>39</sup> Megjithëse Kodi Zgjedhor dhe kalendari i KSHZ-së e caktojnë afatin prej dhjetë ditësh para ditës së zgjedhjeve si datë të fundit për parashtrimin e kërkesave për akreditim, Kodi i Sjelljes së KSHZ-së parasheh pesë ditë.